



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 12787 prot.,

Vlorë, më 23 . 10 .2023

PROJEKT- VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2023

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT QË DO TË ZBATOHET PËR  
KLASIFIKIMIN E FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË KANË APLIKUAR PËR TË  
PËRFITUAR STREHIM NË APARTAMENTET E NDËRTUARA NGA ENTI  
KOMBËTAR I BANESAVE NË LAGJEN “KUSHTRIMI” VLORË, SIPAS  
PROGRAMIT TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT BKU .**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, neni 55 pika 6, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” neni 15, neni 16, neni 44, neni 45, neni 48, neni 49, të ndryshuar më ligjin 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 22/2018 “Për strehimin social” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të “Marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët BKU, në Bashkinë Vlorë” të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banësive dhe Bashkisë Vlorë, me shkresat Nr.2190prot., datë 29.10.2018 për EKB dhe Nr.8801prot., datë 11.10.2018 për Bashkinë Vlorë, pasi mori në shqyrtim Vendimin Nr.1, datë 20.10.2023 të Grupit të Punës të ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.369, datë 17.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë” Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e sistemit të pikëzimit për vlerësimin e dokumentacionit të familjeve që aplikojnë për strehim social” dhe materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike,

**V E N D O S I**

- I. Të miratojë sistemin e pikëzimit që do të zbatohet për klasifikimin dhe miratimin e familjeve dhe individëve, që kanë aplikuar për të përfituar strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banësive në lagjen “Kushtrimi”, sipas programit të banësive me kosto të ulët BKU (tabela bashkëlidhur).
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.
- III. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

**KRYETARI**

**Ermal Dredha**

**Konceptoi: Z.Selmani  
D.Demiri**

Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Tel: 033421201; Fax 033421201; [www.vlora.gov.al](http://www.vlora.gov.al); e-mail: [info@vlora.gov.al](mailto:info@vlora.gov.al)



# FORMATI SISTEMIT TË PIKËZIMIT



	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	Totali 25
A	Nuk disponon apartament në pronësi	5
B	Banojnë në banesa rrezik shembje	3
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	3
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore	3
D	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
E	Familjet e dëbuara apo të nxjerra forcërisht nga banesat e palegalizuara, për shkak të investimeve publike	8
1.2	KUSHTET FAMILJARE	Totali 25
A	Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	5
B	Persona në pension, që nuk janë strehuar në institucionet e përkujdesjes shoqërore.	2
C	Familje me më shumë se katër fëmijë	5
Ç	Familjet e reja	10
D	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	3
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
A	Personat me aftësi të kufizuar	2
B	Personat me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror deri në 30 vjeç	2
C	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimimit të banesave ish-pronarëve	3
Ç	Emigrant i rikthyer, punëtor migrant, azilkërkuesit dhe refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese	1
D	Familje të policëve të rënë në detyrë	2
E	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH	1
Ë	Punonjësit e repartit RENE A	1
F	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	1
G	Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	1
GJ	Anëtarë të komunitetit rom	3
I	Anëtarë të komunitetit egjiptian	3
J	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të	1



K	Vajzat nëna	2
L	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimë për shkak të orientimit seksual, ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	Familje me të ardhura brenda kufijëve të miratuar	25
B	Familje me të ardhura jashtë kufijëve	0





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Mbi projekt-vendimin

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT QË DO TË ZBATOHET PËR  
KLASIFIKIMIN E FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË KANË APLIKUAR PËR TË  
PËRFITUAR STREHIM NË APARTAMENTET E NDËRTUARA NGA ENTI  
KOMBËTAR I BANESAVE NË LAGJEN “KUSHTRIMI”, SIPAS PROGRAMIT TË  
BANESAVE ME KOSTO TË ULËT BKU .**

Në bazë të “Marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët BKU në Bashkinë Vlorë”, të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Vlorë, me shkresat Nr.2190prot., datë 29.10.2018 për EKB dhe Nr.8801prot., datë 11.10.2018 për Bashkinë Vlorë,

Enti Kombëtar i Banesave gjatë viteve 2019-2021 ka financuar dhe ndërtuar në lagjen “Kushtrimi”, Rajoni Nr.5, Vlorë, në territorin e ish-frigoriferit, dy objekte banimi me 8 kate dhe 1 kat nëntokë (garazhe), me 75 apartamente gjithsej me struktura dhe sipërfaqe sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Struktura e apartamentit	Sipërfaqja/m2	Numri i apartamenteve
1	1+1	64	26
2	2+1	77,4	11
3	2+1	81	15
4	2+1	81,4	15
5	3+1	94,4	4
6	Garsoniera	47	4
	<b>GJITHSEJ</b>		<b>75</b>

Nëpërmjet shkresave të përsëritura, duke filluar nga shkresa me Nr.1573prot., datë 08.04.2021 dhe të tjera në vijim, EKB ka kërkuar nga Bashkia Vlorë miratimin dhe vënien në dispozicion të listës së familjeve që do të përfitojnë strehim në këto apartamente sa më parë.

Enti Kombëtar i Banesave i ka sugjeruar Bashkisë Vlorë që të miratojë një listë me 75 emra, të ndjekur nga një listë rezervë me të paktën 40 emra.



Lidhur me fillimin e aplikimeve për familjet e interesuara për të përfituar strehim në këto apartamente Bashkia Vlorë ka shpallur njoftimin publik në shtator 2021. Më tej janë vendosur edhe dy njoftime të tjera për shtyrje dhe vijim të aplikimeve me kërkesë të Këshillit të Bashkisë Vlorë. Njoftimi i shpallur në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë dhe me afishim në godinën e institucionit, në rajonet dhe njësitë administrative, ka dhënë informacion të plotë dhe të detajuar mbi programin në zbatim. Pjesë përbërëse e këtij njoftimi është edhe sistemi i pikëzimit, i cili shërben për të bërë përzgjedhjen e familjeve përfituese. Sipas kuadrit ligjor në fuqi për strehimin social sistemi i pikëzimit miratohet dhe publikohet për çdo program në përputhje me kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit. Në përzgjedhjen e familjeve /individëve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen ato subjekte që përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara për programin në zbatim.

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.369, datë 17.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e sistemit të pikëzimit për vlerësimin e dokumentacionit të familjeve që aplikojnë për strehim social", u mbledh në datën 20.10.2023. Bazuar në përcaktimet e ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", të ndryshuar me ligjin 48/2023 dhe VKM Nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", përgatiti sistemin e pikëzimit, i cili do të shërbejë për klasifikimin e kërkesave dhe përzgjedhjen e familjeve përfituese. Konkretisht grupi i punës u bazua në kriteret specifike të programit të banesave me kosto të ulët sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 16 të ligjit dhe në njohje të plotë të kategorive dhe veçorive specifike të familjeve dhe individëve të pastrehë të qytetit të Vlorës, që kanë aplikuar për të përfituar strehim në këto apartamente për,

**-kushtet e strehimit**, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

- A. Nuk disponojnë apartament në pronësi
- B. Banojnë në banesa rrezik shembje
- C. Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi
- Ç. Kanë ngelur, ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore
- D. Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor
- E. Familjet e dëbuara apo të nxjerra forcërisht nga banesat e palegalizuara, për shkak të investimeve publike

**-kushtet familjare**

- A. Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna
- B. Persona në pension që nuk janë strehuar në institucionet e përkujdesjes
- C. Familje me më shumë se katër fëmijë



Ç. Familjet e reja

D.Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç

**-Kushtet sociale**

A.Personat me aftësi të kufizuar

B.Personat me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror deri në 30 vjeç.

C.Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve

Ç. Emigrant i rikthyer, punëtor migrant, azilkërkuesit dhe refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese

D.Familje e policëve të rënë në detyrë

E. Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejt FNSH

Ë Punonjësit e repartit RENE A

F.Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

G. Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit

GJ.Anëtarë të komunitetit rom

I.Anëtarë të komunitetit egjiptian

J.Të miturit në konflikt me ligjin, pas ekzekutimit të dënimit

K.Vajzat nëna

L. Individët që i përkasin komunitetit LGBTI

**-kushtet ekonomike.**

A.Familje me të ardhura brenda niveleve të përcaktuara

B. Familje me të ardhura jashtë niveleve të përcaktuara

Sistemi i pikëzimit në total përmban 100 pikë, por mënyra e shpërndarjes së pikëve sipas kriterëve të përcaktuara duhet të miratohet nga Këshilli i Bashkisë.

Bashkëlidhur po vendosim një kopje të tabelës së sistemit të pikëzimit të hartuar nga ana jonë, duke mirëpritur edhe sugjerimet e propozimet e anëtarëve të këtij këshilli.

Në përfundim i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë këtë projekt-vendim, me qëllim përzgjedhjen dhe miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar të Banesave.

**KRYETARI**

Konceptoi: D.Mustafai



Miratoi: Z.Selmani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

Nr. 12787 prot.,

Vlorë, më 23.10.2023

MIRATOHET  
KRYETARI

Ermal Dredha

VENDIM

I GRUPIT TË PUNËS TË NGRITUR ME URDHËRIN E BRENDSHËM NR.369, DATË  
17.10.2023 TË KRYETARIT TË BASHKISË VLORË

Nr. 1, datë 20.10.2023



“MBI HARTIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR VLERËSIMIN E  
DOKUMENTACIONIT TË FAMILJEVE QË APLIKOJNË PËR STREHIM SOCIAL”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, neni 55 pika 6, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” neni 15, neni 16, neni 44, neni 45, neni 48, neni 49, të ndryshuar me ligjin nr.48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të “Marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, BKU, në Bashkinë Vlorë” të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Vlorë, me shkresat Nr.2190prot., datë 29.10.2018 për EKB dhe Nr.8801prot., datë 11.10.2018 për Bashkinë Vlorë, Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.369, datë 17.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe i mbledhur në datën 20.10.2023:

VENDOSI

- I. Të hartojë sistemin e pikëzimit që do të shërbejë për vlerësimin e dokumentacionit dhe klasifikimin e kërkesave të familjeve që kanë aplikuar për të përfituar banesë me kosto të ulët BKU, në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen “Kushtrimi”, Vlorë (tabela bashkëlidhur).
- II. Sistemi i pikëzimit në total të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 të përmbajë 25 pikë.



- III. Mënyra e shpërndarjes së pikëve në përputhje me kriteret e përcaktuara, do ti paraqitet për miratim Këshillit të Bashkisë Vlorë, nëpërmjet project-vendimit të hartuar për këtë qëllim.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohet grupi i punës, apo komisioni që do vlerësojë kërkesat dhe dokumentacionin e familjeve strehim kërkuese.
- V. Ky vendim do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Grupi i Punës

1. Irena Toshkallari
2. Sokol Kuçaj
3. Dorian Demiri
4. Irena Stasa
5. Drita Mustafai

